

VENDIM

Nr 12, date 29.03.2021

Në zbatim të nenit 120 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “Për median audiovizive ne RSH”, dhe neneve 80, 82, 83 dhe 84/1 të ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me qëllim realizimin në kohë të detyrimeve ligjore që i takojnë transmetuesit publik në pasqyrimin e fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, mbështetur në vendimin e Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.170, datë 23.03.2021 “Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021” me anë të së cilës është përcaktuar minutazhi falas që u vihet në dispozicion partive politike të regjistruara në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, Këshilli Drejtues i RTSH pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr.prot.1012, datë 26.03.2021, “Propozim për përcaktimin e minutazhit që do t’u vihen të dispozicion partive politike gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”, në mbledhjen e tij datë 29.03.2021, me votimin pro të 7 anëtarëve të pranishëm L.Bungo, I.Keko, D. Papadhimitri, G.Permeti, H.Haliti, M.Shanaj dhe A.Reçi:

VENDOSI:

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi prej 90 minutash, përkatësisht 60 minuta në Televizionin Publik dhe 30 (tridhjetë) minuta në Radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, të subjekteve zgjedhore :

- a) Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”;
- b) Partia Socialiste e Shqipërisë,

e cila të ndahet në :

- RTSH (TV) në 12 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (12 x 5 minuta).
- Radio Tirana në 6 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (6 x 5 minuta).

2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi prej 45 (dyzetepesë) minutash, përkatësisht 30 tridhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë)

KESHILLI DREJTUES I RTSH

minuta në Radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, të partive parlamentare si vijon;

- a) Partia Socialdemokrate
- b) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

e cila të ndahet në :

-RTSH (TV) në 6 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (6 x 5 minuta).

-Radio Tirana në 3 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (3 x 5 minuta).

3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi prej 20 (njëzet) minutash, përkatësisht në 10 (dhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, të partive jo parlamentare dhe koalicionit si vijon;

- a) Partia Lëvizja për Ndryshim,
- b) Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare.
- c) Partia Bindja Demokratike.
- ç) Partia Balli Kombëtar,
- d) Partia Lëvizja e Re,
- dh) Partia Aleanca Demokracia e Re,
- e) Partia Nisma Thurje.
- ë) Koalicioni "ABEOK"

e cila të ndahet në :

-RTSH (TV) në 2 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (2 x 5 minuta).

-Radio Tirana në 2 intervale ditore, ku çdo njëra prej tyre ka një hapësirë kohore prej 5 minutash (2 x 5 minuta).

4. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minuta përkatësisht 5 (pesë) minuta në Televizionin Publik dhe 5 (pesë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, për secilin prej 5 (pesë) kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit;

- a) Elton Lahim Debreshi,
- b) Kreshnik Luan Merxhani,
- c) Iljaz Jashar Shehu,
- ç) Bojken Xhelal Abazi,
- d) Pal Marash Shkambi

e cila të ndahet në :

-RTSH (TV) në 1 interval ditor, me një hapësirë kohore prej 5 minutash (1 ditë x 5 minuta).

KESHILLI DREJTUES I RTSH

- Radio Tirana në 1 interval ditor, me një hapësirë kohore prej 5 minutash (1 ditë x 5 minuta).
5. Mbështetur në pikën 2 të nenit 80 të Kodit Zgjedhor, minutazhi falas që përfitojnë partitë politike, sipas pikave të mësipërme, nuk mund të caktohet si pjesë e lajmeve dhe programeve informative.
 6. Intervallet kohore mund të shfrytëzohen për thirrje elektorale dhe spote.
 7. RTSH transmeton reklama politike pa pagesë, duke llogaritur kohën e transmetimit brenda minutazhit të përcaktuar më lart.
 8. Mbështetur në pikën 1 të nenit 83 të Kodit Zgjedhor, hedhja e shortit për caktimin e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar propozojmë të kryhet ditën e hënë, datë 29 mars 2021, ora 12:00, në godinën qendrore të RTSH-së.
 9. Në zbatim të pikës 2 të nenit 83 të Kodit Zgjedhor propozojmë që minutazhi falas në dispozicion të partive politike të transmetohet në fashën orare 18:30 – 19:00, duke filluar nga data 1 prill 2021 deri më datë 23 prill 2021.
 10. Një kopje e vendimit të Këshillit Drejtues të RTSH do t'i dërgohet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
 11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Leka BUNGO

